



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 466/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie Morina-Ajvazi, duke vendosur lidhur me apelin e subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, për shkak të mospërputhjes së rezultateve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.466/2019 e datës 08.11.2019, i paraqitur nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, për shkak të mospërputhjes së rezultateve.

A r s y e t i m

Me datë 08.11.2019, subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.466/2019, me të cilën kërkon që të dijë se përse ka ndryshuar rezultati, ku subjekti politik NDS, ka pasur 4070 vota në Rezultatet Preliminare, ndërsa pas publikimit të Rezultatit Përfundimtar të dt. 07.11.2019 kanë pasur 3934 vota.

Në përgjigje në ankesë të datës 08.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se asnjë Formularë që nuk ka përputhje mes votave të subjekteve me votat e Kandidateve nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti do ti nënshtrohet Auditimit në QNR, më tutje thekson se pala ankuese nuk ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk ka prezantuar mjaftueshëm prova për rastin konkret.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtresuesi i apelit pretendimet e tij, nuk i ka mbështetur me asnjë prove materiale por vetëm dyshon në parregullsi, që vlerësohen si pretendime të supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në

rastin konkret, Paneli, nuk mundi të konstatoj faktin se ka pasur gabime gjatë rezultateve të publikuara në FRP, në vendvotimet e lartcekur, ashtu siç pretendohet në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Subjekti Politik NDS, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë gabim dhe mospërputhje të rezultateve.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.466/2019 më datën 09.11.2019

Kryesuesi i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.